# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-474125**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Tifogrupet "i vënë flakën" Prishtinës: UÇK-ja nderohet kur shqiptaria bashkohet |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394506.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 15:13:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 27 shtator 2026, 14:59:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 27 shtator 2026, 14:58:00 UTC → 27 shtator 2026, 15:00:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8c5a992c958e0505aa568c5ed75d6efe7fe54ea6b2b909a0cc3654731073e1e7` |
| TEKSTI | `a84c64c0ad3549d4279f637eaf40d43a0ee51662d504781c3461f666bd0eaa5e` |
| PAMJA | `322d03e4e11a1f2a1096c64b23a0a5e4ceec26325a446a0eea51dd1d4366cad9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0a21fe394262132db68701c7d799b13ad52dad5343cd21685030f485252745c7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3dbf5264f26ae921c8f8735760cb378b1b626a14b73f487ffe641eb8f02fca55` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0a21fe394262132db68701c7d799b13ad52dad5343cd21685030f485252745c7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Tifogrupet “i vënë flakën” Prishtinës: UÇK-ja nderohet kur shqiptaria bashkohet

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 27.09.2026, 16:59

Share Share




Prishtina është bërë sot pikëtakimi i tifogrupeve shqiptare, të cilat janë mbledhur në një protestë të përbashkët në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), pak kohë pas dënimit të tyre në Hagë.

Tifozë të ardhur nga qytete të ndryshme shqiptare kanë marshuar në sheshet dhe rrugët e kryeqytetit të Kosovës, duke mbajtur flamujt kombëtarë dhe atë të Kosovës. Gjatë protestës janë dëgjuar thirrje në mbështetje të ish-drejtuesve të UÇK-së, ndërsa pjesëmarrësit kanë përcjellë mesazhe kundër zhvillimeve të fundit në procesin gjyqësor.

Ajo që e veçon protestën është pjesëmarrja e gjerë e grupeve të tifozëve nga trevat shqiptare, të cilat për këtë tubim kanë lënë mënjanë rivalitetet sportive dhe janë shfaqur së bashku në Prishtinë.

Atmosfera është shoqëruar edhe me ndezjen e flakadanëve të zinj, të përdorur nga tifozët si simbol proteste dhe kundërshtimi. Pamjet nga tubimi kanë përcjellë një mesazh të qartë për bashkimin e tifozëve rreth kauzës së tyre.

“UÇK-ja nderohet kur shqiptaria bashkohet” ishte një nga mesazhet që shoqëroi protestën, e cila mblodhi tifozë nga disa prej grupeve më të njohura shqiptare.

Një tubim që, përtej rivaliteteve në tribuna, solli në të njëjtin shesh tifozë nga qytete të ndryshme shqiptare.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

## TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.